

Ekspteri Juridik Mersim Maksuti flet per kompetencat e BDIs ! (VIDEO)

Maqedonia

Postuar nga: redaksia

Postuar në: 2015/12/9 12:26:45



Ekspteri juridik, Mersim Maksuti, vlerëson se partitë e koalicionit në pushtet, BDI dhe VMRO DPMNE, jo vetëm që nuk kanë shkrirje të mirëfilltë të platformave, por kanë përplasje kompetencash në qeveri. Për ministrinë e rëndësishme që i udhëheq BDI, sipas Maksutit, VMRO-DPMNE-ja ka vendosur zëvendëskryeministra me më shumë kompetenca. Pavarësisht se BDI-ja menaxhon me Ministrinë e Ekonomisë, mes ministrit të ekonomisë Bekim Neziri dhe zëvendëskryeministrit për çështje ekonomike, Vladimir Peshevski, ekziston dallim në fuqinë vendimmarrëse. Sipas Maksutit, ky është problem politik i cili rrjedh si pasojë e mungesës së vullnetit politik të BDI-së dhe ministrave të saj.

Ndër ngecjet më të mëdha në sferën e Ekonomisë, pavarësisht se dikasteri udhëhiqet nga ministër nga radhët e BDI-së, mund të numërohen ngecja e Zonave të lira ekonomike në Tetovë dhe Kërçovë, premtimet pa rezultat për krijimin e klimave të përshtatshme për bizneset shqiptare, mospërfillja e Këshillit të Evropës mbi rrezikun që i shkaktohet parkut nacional "Mavrova" nga projektet për hidrocentralet "Boshkov Most" dhe "Fusha Llukovës", mos përgjegjësia për zhbllokimin e produkteve të importuara nga Shqipëria, gjykimet se kompanitë nuk shfrytëzojnë fondet nga BE-ja dhe të tjera.

Adrian Kerimi /SHENJA/